



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 03. REGJISTRI TË PARAQITUR NË KQZ
NGA PARTIA BINDJA DEMOKRATIKE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

KËRKUES: Partia "Bindja Demokratike"

OBJEKT: Kundërshtimi i Vendimit nr.7 datë 22.05.2019 të KZAZ nr.79 "Për mosregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Libohovë"

BAZË LIGJORE: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 68; 70; 71; 72 73; 124, 143, pika 1, gërma "c" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e palëve,



Nr. 656 i Vendimit Data 27.05.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 03, datë 25.05.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike

VËREN

Partia Bindja ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore nr.03, datë 25.05.2019, me objekt "Kundërshtimi i Vendimit nr.7, datë 22.05.2019, të KZAZ nr. 79 "Për mosregjistrimin e listës shumemërore për këshillin e bashkisë Libohovë propozuar nga subjekti politik Partia Bindja Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019."

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me nenet 134 e vijues të Kodit Zgjedhor, në seancën plenare të datës 27.05.2019, ora 12:00, zhvilloi shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr.03 regj., sipas objektit të sipërcituar.

Në mbledhjen e datës 27.05.2019, KQZ përpara nisjes së hetimit administrativ në mbështetje të nenit 135, pika 3 verifikoi legjitimitetin e palëve dhe konstatoi se për ankimin nr. 03 subjekti ankues i vetëm, është Partia Bindja Demokratike.

- Pala ankuese në ankimin e paraqitur në datë 25.05.2019 pretendon se:

Me vendimin nr.7 datë 22.05.2019 të KZAZ nr.79, Bashkia Libohovë, ka vendosur mosregjistrimi e listës shumemërore për këshillin e bashkisë Libohovë, propozuar nga subjekti Bindja Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.

1. Subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike më datë 13.05.2019 me nr.3386 prot., ka depozituar kërkesën për regjistrimin e listës shumemërore për këshillin e bashkisë Libohovë, pranë KZAZ-së dhe KQZ-së.
2. KZAZ-ja nr.79 me shkresën nr.02 prot., datë 14.05.2019 i ka kërkuar subjektit Bindja Demokratike plotësimin e dokumentacionit pasi nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se mungon dokumentacioni si më poshtë:
 - Numri i kandidatëve për anëtar këshilli nuk duhet të jetë më vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në këshillin e Bashkisë;
 - Deklarat e kandidatëve Model 05 – K, për 15 kandidatët;
 - Certifikatë lindjeje/ personale ose kopje e dokumentit të identifikimit;
 - Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore Model - 09 K
 - Formularin tip për mbledhjen e nënshkrimeve që mbështesin kandidatin Model 07-K.
3. Subjekti zgjedhor Bindja Demokratike në datën 16.05.2019 me nr.3386/1 prot., ka depozituar në KQZ dokumentacion shtesë për plotësimin e kërkesës për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkisë Libohovë si më poshtë:
 - Lista shumemërore Model 10 K
 - Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore Model - 09 K
 - Deklaratat e kandidatëve sëbashku me kartat e identitetit për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
 - Formularët e vetëdeklarimit sëbashku me CV për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
 - Vërtetim për zotërimin e mandatit në Kuvendin e Shqipërisë.



Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019 afati i fundit i përlogaritur është data 13 maj 2019.

Vendimi i sipërcituar i KZAZ-së nr.79, Bashkia Libohovë, ka vendosur mosregjistrimi e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Libohovë, propozuar nga subjekti Bindja Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019 me arsyetimin e mungesës së dokumentacionit të cituar dhe në shkresën e së mësipërme me nr.02 prot., datë 14.05.2019. sipas ankuesit është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.

Pas paraqitjes së pretendimeve të palës ankuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për nevoja të hetimit administrativ, vendosi të administrojë kryeisht në përputhje me nenin 136, pika 2 dokumentacionin e depozituar nga Partia Bindja Demokratike pranë zyrës së protokollit të KQZ-së.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se me shkesën me nr.3386/1 prot., datë 16.05.2019, Partia Bindja Demokratike ka depozituar Formularët e Vetëdeklarimit, kopje te kartave të identitetit për të gjithë kandidatët për anëtar në këshillin bashkiak, Modelin 09 K si dhe autorizimi i z. Florian Hajdini për dorëzimin e dokumentacionit të kandidimit për anëtar në këshillin e bashkisë Libohovë, pranë KQZ-së.

Duke qenë se dokumentacioni u provua që është dorëzuar pranë KQZ-së nga subjekti zgjedhor Bindja Demokratike, referuar nenit 59 të Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", lejon dorëzimin e dokumenteve, paraqitjen e dokumentacionit edhe organin qendror ose në degën e tij. KQZ me vendim të ndërmjetëm vendosi të administrojë në cilësinë e provave shkresat e sipërpërmendura.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 143, pika 1, germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, duhet të vendosë ndryshimin e vendimit nr.07, datë 22.05.2019 "Për mos regjistrimin e listës shumëmemërore për Këshillin e Bashkisë Libohovë të KZAZ-së nr.79 dhe regjistrimin e listës shumëmemërore të subjektit zgjedhor Bindja Demokratike për këshillin e Bashkisë Libohovë, që mbyllet me nr rendor 15.

Për sa më sipër kërkesa ankimore e Partisë Bindja Demokratike është e mbështetur në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 68;70; 71; 72; 73; 124, 143, pika 1, germa "c" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar



Nr. 656 i Vendimit Data 27.05.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 03, datë 25.05.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e vendimit të KZAZ-së nr.79 dhe detyrimin për regjistrimin e listave shumëmemërore të subjektit zgjedhor Bindja Demokratike në Këshillin e Bashkisë Libohovë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

